



**Republika e Kosovës**  
**Republika Kosovo - Republic of Kosovo**  
*Kuvendi - Skupština - Assembly*

---

**Ligji Nr. 04/L-108**

**PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TATIMIN MBI  
VLERËN E SHTUAR Nr. 03/L-146, I NDRYSHUAR DHE PLOTËSUAR  
ME LIGJIN NR. 03/L-197**

**Kuvendi i Republikës së Kosovës;**

Në bazë të nenit 65 (1) të Kushtetutës së Republikës së Kosovës,

Miraton

**LIGJ PËR NDRYSHIMIN DHE PLOTËSIMIN E LIGJIT PËR TATIMIN  
MBI VLERËN E SHTUAR Nr. 03/L-146, I NDRYSHUAR DHE  
PLOTËSUAR ME LIGJIN NR. 03/L-197**

**Neni 1**

Pas nenit 1 të ligjit bazik shtohet nen i ri 1.A me emërtimin dhe përmbajtjen si vijon:

**Neni 1.A**  
**Qëllimi i ligjit**

Qëllimi i këtij ligji është rregullimi i situatave të veçanta të cilat me Ligjin 03/L-146, të ndryshuar, nuk janë mbuluar në përputhje me direktivën e BE-së për TVSH-në, Përcaktimi i vendit të furnizimit të mallrave për personat e tatueshëm, vendi i furnizimit të shërbimit, transporti ndërkombëtar i pasagjerëve dhe transporti i mallrave të tyre shoqëruese, rregullimet për zbritjen e TVSH-së së zbritshme dhe mallrat nën aranzhime të posaçme doganore.

## Neni 2

1. Neni 2 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.5, në fund të nën-paragrafit shtohet teksti si në vijim:

“Si mallra kapitale duhet të konsiderohen edhe ato shërbime të cilat i kanë karakteristikat e ngjashme me ato të cilat i atribuohen mallrave kapitale në qoftë se kosto totale e këtyre shërbimeve e tejkalon shumën njëzet mijë (20.000) Euro. Ministri i Financave mund të nxjerrë një akt nën-ligjor për përkufizimin e mallrave kapitale”.

2. Neni 2 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.6., riformulohet me tekstin si në vijim:

1.6. **Pasuri e prekshme** - çdo pasuri që përfshin me sa vijon:

Nën-paragrafët 1.6.1, 1.6.2. dhe 1.6.3. të paragrafit 1.6. mbesin të pandryshuara.

3. Neni 2 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.8. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.8. **Konsiderata** - çdo veprim ose akt i heqjes dorë në lidhje me furnizimin e mallrave ose shërbimeve, dhe/apo duhet të përfshijë çdo shumë që është e pagueshme ose mallrat apo shërbimet e pranuar nëpërmes të transaksionit barter.

4. Neni 2 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.21.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.21.1. TVSH e obliguar apo e paguar në Kosovë në lidhje me mallrat apo shërbimet e furnizuara ose që do t'i furnizohen atij nga një person tjetër i tatueshëm.

5. Neni 2 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.21.2. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.21.2. TVSH e obliguar apo e paguar në lidhje me importimin e mallrave në Kosovë.

6. Neni 2 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.43. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.43. **Bordi i Pavarur i Rishqyrtimit** - Bordi i themeluar me Ligjin për Administratën Tatimore dhe Procedurat, dhe është kompetent për pranimin e ankesave sa i përket taksave të paraqitura nga taksapaguesit deri në nëntor 2012.

7. Neni 2 i ligjit bazik, pas nën-paragrafit 1.43. shtohet nën-paragrafi i ri 1.44. me tekstin si në vijim

1.44. **Gjykata kompetente** - gjykata e përcaktuar në Ligjin Nr. 04/L-102 për plotësim ndryshim të ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat Nr 03/L-222.

### **Neni 3**

Neni 3 i ligjit bazik paragrafi 2. fshihet nga teksti i ligjit.

### **Neni 4**

Neni 6 i ligjit bazik, paragrafi 5. riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Personat të cilët nuk janë të vendosur në Kosovë i nënshtrohen regjistrimit të TVSH-së nga fillimi i zhvillimit të aktivitetit ekonomik në Kosovë. Personat e tillë të tatueshëm që nuk janë të vendosur në Kosovë, duhet ta emërojnë një përfaqësues tatimor ashtu siç është referuar në paragrafin 2. të nenit 26 të këtij ligji. Personi i tatueshëm do të regjistrohet me emrin e tij dhe në emrin e përfaqësuesit të tij tatimor brenda pesë (5) ditëve pas emërimit si përfaqësues tatimor dhe para fillimit të aktivitetit ekonomik në Kosovë. Megjithatë, ata nuk janë të obliguar të regjistrohen, në qoftë se ata kryejnë vetëm furnizime ndaj pranuesit i cili është i obliguar të paguajë TVSH-në sipas nenit 52 nën-paragrafi 1.2. dhe 1.3. i ligjit bazik, mirëpo akoma do të konsiderohen persona të tatueshëm.

### **Neni 5**

Neni 10 i ligjit bazik, nën-paragrafi 2.2. në fund të nën-paragrafit shtohet teksti si në vijim:

“Ministri i Financave mund të nxjerrë akt nën-ligjor që definojnë aplikimin e këtij nën-paragrafi”.

### **Neni 6**

Neni 12 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Me përjashtim të rasteve të referuara në nenin 13 të ligjit bazik, mbajtja e mallrave nga personi i tatueshëm, ose nga pasardhësi i tij, kur ai ka pushuar së zhvilluari aktivitetin e tij ekonomik apo ka ndërprerë regjistrimin, ku TVSH-ja në ato mallra bëhet plotësisht ose pjesërisht e zbritshme me përvetësimin e tyre ose me shfrytëzimin e tyre në pajtueshmëri me paragrafin 1. të këtij neni, gjithashtu konsiderohen si furnizime të mallrave për konsideratë.

## Neni 7

1. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Personi, të cilit i transferohen mjetet duhet të trajtohet si pasardhës i transferuesit në lidhje me mjetet e transferuara dhe nuk duhet të ngarkohet me TVSH në atë transfer, me kusht që pasardhësi i transferuesit është person i tatueshëm i cili është i regjistruar ose është i obliguar të regjistrohet për nevoja të TVSH-së. Transferuesi dhe ai që pranon transferin, duhet të njoftojnë ATK-në për qëllimin e tyre për zbatimin e këtij neni së paku tridhjetë (30) ditë para se të ndodhë transferi.

2. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 3. riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Çdo obligim i pa paguar dhe e drejtë e transferuesit në lidhje me mjetet e transferuara i paraparë me anën e këtij ligji para kohës së transferit, bëhet detyrim dhe e drejtë e pranuesit të transferit.

3. Neni 13 i ligjit bazik, paragrafi 4. fshihet nga teksti i ligjit dhe paragrafi 5. rinumërohet si paragraf 4.

## Neni 8

Titulli i nenit 15 të ligjit bazik **“Shfrytëzimi i mallrave të biznesit për nevoja jo-biznesore”** ndryshohet dhe zëvendësohet me titullin **“Shfrytëzimi i mallrave dhe shërbimeve të biznesit për nevoja jo-biznesore”**.

## Neni 9

1. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Ministri i Financave përmes një akti nënligjor mund të vendos të trajtojë si furnizim të shërbimeve për konsideratë furnizimin e disa shërbimeve të caktuara nga personi i tatueshëm për qëllime të biznesit të tij, ku TVSH-ja për një shërbim të tillë, në qoftë se furnizohet nga një person tjetër i tatueshëm nuk do të jetë plotësisht i zbritshëm”.

2. Neni 16 i ligjit bazik, paragrafi 2. fshihet nga teksti i ligjit.

## **Neni 10**

1. Neni 19 i ligjit bazik, pas nën-paragrafit 2.2. shtohet nën-paragrafi i ri 2.3. me tekstin si në vijim:

2.3. Ministri i Financave mund të nxjerrë akt nënligjor për të përcaktuar vendin e furnizimit të mallrave në rastet ku disa persona hyjnë në transaksione për të njëjtin mall dhe kur malli gjatë transportit apo dërgimit lëviz drejtpërdrejtë prej furnizuesit të parë tek pranuesi i fundit.

2. Neni 19 i ligjit bazik, nën-paragrafi 3.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

3.1. Kur mallrat furnizohen në kuverta të aeroplanëve ose trenave gjatë pjesës së operacionit të transportit të pasagjerëve që kryhen brenda Kosovës, vendi i furnizimit do të jetë Kosova.

3. Neni 19 i ligjit bazik, nën-paragrafët 3.2. dhe 3.3. fshihen nga teksti i ligjit.

## **Neni 11**

1. Neni 20 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.1. çdo person që zhvillon aktivitetin e tij ekonomik ashtu siç është referuar në nenin 4 të këtij ligji.

2. Neni 20 i ligjit bazik, nën-paragrafët 1.1.1. dhe 1.1.2. si dhe nën-paragrafi 1.2. fshihen nga teksti i ligjit.

3. Neni 20 i ligjit bazik, nën-paragrafi 2.2.2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.2.2. vendi i furnizimit të transportit të pasagjerëve është vendi ku transporti kryhet, në proporcion me distancat e mbuluara.

4. Neni 20 i ligjit bazik, nën-paragrafi 2.2.4. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.2.4. vendi i furnizimit të shërbimeve të restorantit dhe shërbimeve të furnizimit me ushqim përveç atyre të zhvilluara fizikisht në kuvertën e aeroplanëve ose trenave gjatë pjesës së operacionit të transportit të pasagjerëve që kryhen brenda Kosovës, do të jetë vendi ku fizikisht kryhen shërbimet;

5. Neni 20 i ligjit bazik, nën-paragrafi 2.2.6. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.2.6. vendi i furnizimit të shërbimit ku fizikisht kryhen shërbimet e restorantit dhe shërbimet e furnizimit me ushqim në kuvertën e aeroplanëve ose trenave gjatë pjesës së operacionit të transportit të pasagjerëve të kryera brenda Kosovës, duhet të jetë Kosova.

6. Neni 20 i ligjit bazik, nën-paragrafi 3.2.7. riformulohet me tekstin si në vijim:

3.2.7. vendi i furnizimit të shërbimeve të restorantit dhe furnizimit me ushqim të cilat fizikisht kryhen në kuvertën e aeroplanëve ose trenave gjatë pjesës së operacionit të transportit të pasagjerëve të kryera brenda Kosovës, duhet të jetë Kosova.

## **Neni 12**

1. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 2. pjesa e parë e paragrafit riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Rregullat Specifike:

Nën-paragrafët e paragrafit 2. mbesin të pa ndryshuar.

2. Neni 22 i ligjit bazik, paragrafi 3. pjesa e parë e paragrafit riformulohet me tekstin si në vijim:

3. Pagesat ose lëshimi i faturave:

Nën-paragrafët e paragrafit 3. mbesin të pa ndryshuar.

3. Neni 22 i ligjit bazik, nën-paragrafi 4.2. fshihet nga teksti i ligjit.

## **Neni 13**

1. Neni 23 i ligjit bazik nën-paragrafi 2.1. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.1. Mallrat që hyjnë në Kosovë vendosen në një regjim pezullues, një procedurë doganore me ndikim ekonomik apo një trajtim të miratuar të doganave ashtu siç referohet në legjislacionin doganor, me lirim të plotë nga detyrimi i importit. Momenti i lindjes së detyrimit do të ndodh dhe TVSH-ja do të bëhet e ngarkueshme vetëm kur mallrat pushojnë të jenë të mbuluara nga këto aranzhime, procedura apo trajtime. Megjithatë, kur mallrat e importuara i nënshtrohen detyrimeve doganore, ndodh momenti i lindjes së detyrimit dhe TVSH-ja bëhet e ngarkueshme kur momenti i lindjes së detyrimit lidhur me ato detyrime ndodh, dhe ato detyrime bëhen të ngarkueshme.

2. Neni 23 i ligjit bazik, nën-paragrafi 2.2. fshihet nga teksti i ligjit.

3. Neni 23 i ligji bazik nën-paragrafi 2.3. bëhet nën-paragrafi 2.2.

4. Neni 23 i ligjit bazik pas nën-paragrafit të rinumëruar si paragrafi 2.2.. shtohet nën-paragraf i ri 2.3. me tekstin si në vijim:

2.3. për mallrat e vendosura nën procedurë të importimit të përkohshëm me lirim të pjesshëm nga detyrimet doganore, do të ndodh momenti i lindjes së detyrimit dhe TVSH-ja do të bëhet e ngarkueshme vetëm kur mallrat pushojnë të jenë të mbuluara nga kjo procedurë.

## **Neni 14**

1. Neni 25 i ligjit bazik pas paragrafit 1.1. shtohen nën-paragraf të ri 1.2. dhe 1.3. me tekstin si në vijim:

1.2. kur mallrat e eksportuara përkohësisht nga Kosova, ri-importohen në Kosovë pasi që t'i jenë nënshtuar riparimit, përpunimit, adaptimit, punimit apo ri-punimit jashtë Kosovës, shuma e tatueshme duhet të jetë vlera e riparimit, përpunimit, adaptimit, punimit apo ri-punimit.

1.3. nëse mallrat janë furnizuar, derisa ato janë vendosur nën një aranzhim, procedurë apo trajtim ashtu siç është referuar në nenin 23, nën-paragrafi 2.1. i këtij ligji, shuma e tatueshme do të jetë vlera e furnizimit të fundit, plus vlera e shërbimeve të liruara të kryera lidhur me mallrat pas furnizimit të fundit.

2. Neni 25 i ligjit bazik, nën-paragrafët aktual 1.2. dhe 1.3. do të bëhen nën-paragrafët 1.4. dhe 1.5. dhe nën-paragrafi aktual 1.4. fshihet nga teksti i ligjit.

3. Neni 25 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.4.3. referimi në nën-paragrafin 1.2.2. do të ndryshohet në referimin 1.4.2.

4. Neni 25 i ligjit bazik i shtohet nën-paragrafi i ri 1.4.4. me tekstin si në vijim:

1.4.4. lidhur me mallrat që pushojnë të mbulohen nga një aranzhim, procedurë apo trajtim ashtu siç referohet në nenin 23, nën-paragrafi 2.1. i këtij ligji, shuma e tatueshme do të përfshijë vlerën e shërbimeve të liruara që janë kryer lidhur me mallrat. Nën-paragrafi 1.3. aplikohet për mallrat që janë furnizuar derisa ato kanë qenë të vendosura nën një aranzhim, procedurë apo trajtim ashtu siç është referuar në nenin 23, nën-paragrafi 2.1. të këtij ligji.

## **Neni 15**

1. Neni 27 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.1. fshihet teksti “në veçanti në ngarkimin e çmimeve të krahasueshme ose”, pjesa tjetër e fjalisë mbetet e njëjtë.

2. Neni 27 i ligjit bazik, nën-paragrafët 1.6., 1.7. dhe 1.8. në pjesën e fundit të tyre fshihet teksti “dhe bëhen me çmime të krahasueshme”.

3. Neni 27 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.18. në pjesën e fundit i shtohet teksti si në vijim:

Kodi 4902 Gazetat, revistat dhe periodiket, nëse janë apo jo të ilustruara apo që përmbajnë materiale reklamuese

4. Neni 27 i ligjit bazik, pas paragrafit 1.18. shtohet nën-paragrafi i ri 1.19. me tekstin si në vijim:

1.19. Furnizimet e shërbimeve për mediat elektronike dhe të shtypura.



## **Neni 16**

1. Neni 28 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.8. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.8. Furnizimi në vlerën nominale të pullave fiskale dhe pullave të tjera të ngjashme.

2. Neni 28 i ligjit bazik, paragrafi 2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2. Nga lirimet e parapara në nën-paragrafin 1.2. të paragrafit 1. të këtij neni, duhet të përjashtohen si në vijim:

3. Neni 28 i ligjit bazik, nën-paragrafi 3.4. ndryshohet referenca e tanishme “nën-paragrafi 3.1. të këtij neni” dhe bëhet “nën-paragrafi 1.3. të këtij neni.”

4. Neni 28 i ligjit bazik, pas paragrafit 3. shtohet paragrafi i ri 4. me tekstin si në vijim:

4. Furnizimi i mallrave që do të shfrytëzohet vetëm për aktivitete të lira sipas nenit 27 dhe nenit 28 të këtij ligji, në qoftë se për këto mallra nuk ka lind e drejta e zbritjes.

## **Neni 17**

1. Neni 29 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.8. fshihet nga teksti i ligjit.

2. Neni 29 i ligjit bazik, nën-paragrafët aktual 1.9. dhe 1.10. bëhen nën-paragrafët 1.8. dhe 1.9.

3. Neni 29 i ligjit bazik, pas paragrafit 1.10. shtohen dy nën-paragraf të ri 1.11. dhe 1.12. me tekstin si në vijim:

1.11. mallrat e importuara që janë vendosur në një aranzhim pezullimi, procedurë doganore me ndikim ekonomik apo trajtim të miratuar të doganave, ashtu siç është referuar në paragrafin 2.1. të nenit 23 të këtij ligji, dhe eksportohen jashtë Kosovës kur mallrat pushojnë të jenë të mbuluara nga aranzhimi, procedura apo trajtimi.

1.12. mallrat e importuara për/apo nga mediat elektronike dhe të shtypura vetëm për qëllim të tyre.

## Neni 18

1. Neni 31 i ligjit bazik, nën-paragrafi 1.5. riformulohet si në vijim:

1.5. Furnizimi i shërbimeve, duke përfshirë transportin dhe shërbimet ndihmëse, mirëpo duke përjashtuar shërbimet e liruara në pajtueshmëri me nenet 27 dhe 28, kur këto janë direkt të lidhura me eksportimin apo importimin e mallrave. Lidhur me importimin lirimet aplikohen vetëm për shërbimet që do të përfshihen në shumën e tatueshme sipas nën-paragrafit 1.4.2. të nenit 25. të ligjit bazik

2. Neni 31 i ligjit bazik, paragrafi 2, teksti pas nën-paragrafit 2.1.3. fshihet dhe zëvendësohet me tekstin si në vijim:

“Udhëtari i cili nuk është i vendosur brenda Kosovës nënkupton udhëtarin ku adresa e tij e përhershme ose vendbanimi i tij i zakonshëm nuk është i vendosur brenda Kosovës. Në atë rast “adresë e përhershme apo rezidencë e zakonshme” nënkupton vendin e regjistruar në pasaportë, letërnjoftim ose dokument tjetër. Dëshmia e eksportimit duhet të bëhet nëpërmes të faturës ose dokumenteve të tjera në vend të saj, të nënshkruar nga zyra e doganës në dalje nga Kosova”.

3. Neni 31 i ligjit bazik, nën-paragrafi 2.2. riformulohet me tekstin si në vijim:

2.2. aplikimi i lirimimit të referuar në paragrafin 2. të këtij neni, definohet me një akt nënligjor që nxirret nga Ministri i Financave i cili gjithashtu do të caktoj datën prej së cilës fillon aplikimi i lirimimit.

## Neni 19

1. Neni 33 i ligjit bazik, pas paragrafit 4. shtohet paragraf i ri 5. me tekstin si në vijim:

5. Transporti ndërkombëtar i pasagjerëve dhe transporti i mallrave të tyre shoqëruese, siç janë valixhet ose furnizimet e shërbimit që lidhen me transportin e pasagjerëve.

5.1. transporti ndërkombëtar i pasagjerëve nënkupton transportin e pasagjerëve me tren, aeroplan, autobus kur transporti kryhet:

5.1.1. nga një vend në territorin e Kosovës në një vend jashtë territorit të Kosovës, apo

5.1.2. nga një vend jashtë territorit të Kosovës në një vend në territorin e Kosovës.

## **Neni 20**

Neni 35 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Transaksionet vijuese të trajtuara si eksport janë të liruara:

1.1. furnizimi i mallrave që janë vendosur nën një aranzhim, procedurë apo trajtim ashtu siç është referuar në nenin 23, nën-paragrafi 2.1 të këtij ligji.

1.2. furnizimi i shërbimeve që drejtpërdrejtë kanë të bëjnë me mallrat e vendosura nën një aranzhim, procedurë apo trajtim ashtu siç është referuar në nenin 23, nën-paragrafi 2.1 të këtij ligji.

2. Furnizimi i mallrave në “duty free shops” në aeroport me linja ajrore ndërkombëtare, me kusht që udhëtarët të bartin mallrat e tilla si valixhe personale në një vend tjetër përmes mjetit ajror. Për qëllime të këtij paragrafi udhëtari konsiderohet të jetë një person i cili ka biletën ku përmendet destinimi i aeroportit apo portit detar të një vendi tjetër.

3. Furnizimi i mallrave i ofruar për mjete ajrore për shitje për udhëtarët në bord ku vendi i arritjes gjendet jashtë Kosovës.

## **Neni 21**

1. Neni 36 i ligjit bazik, në paragrafin 5, pas nën-paragrafit 5.3. shtohen nën-paragrafët e ri 5.4. dhe 5.5. me tekstin si në vijim:

5.4. në rast se pasuria e paluajtshme që është pjesë e asetëve të biznesit të një personi të tatueshëm dhe shfrytëzohet për qëllime të biznesit të personit të tatueshëm dhe për shfrytëzim privat ose për stafin e tij, ose, më në përgjithësi, për qëllime tjera nga ato të biznesit të tij, TVSH-ja mbi shpenzimet që lidhen me këtë pasuri do të jenë të zbritshme vetëm deri në proporcionin e shfrytëzimit të pasurisë për qëllime të biznesit të personit të tatueshëm.

5.5. si përjashtim i nenit 15 të ligjit bazik, ndryshimet në proporcionin e shfrytëzimit të pasurisë së paluajtshme të referuara në nën-paragrafin 5.4. do të merren parasysh në përputhje me parimet e përcaktuara në nenin 41 të ligjit bazik.

2. Neni 36 i ligjit bazik, nën-paragrafi 5.4. bëhet nën-paragrafi 5.6.

## Neni 22

1. Neni 37 i ligjit bazik, nën-paragrafi 3.2. referenca “**nenit 37**” zëvendësohet me referencën “**nenit 36**”.
2. Neni 37 i ligjit bazik, nën-paragrafi 3.4. referenca “**nenit 53**” zëvendësohet me referencën “**nenit 52**”.

## Neni 23

Neni 38 i ligjit bazik, paragrafi 1. riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Personat e tatueshëm bëjnë zbritjen duke zbritur nga shuma totale e obligimit të TVSH-së për një periudhë të caktuar tatimore, shumën totale të TVSH-së në lidhje me të cilën gjatë së njëjtës periudhë ka lindur e drejta për ta zbritur në pajtueshmëri me paragrafin 1. dhe 2. të nenit 37 të ligjit bazik.

## Neni 24

1. Neni 41 i ligjit bazik, riformulohet me tekstin si në vijim:

1. Zbritja fillestare duhet të rregullohet:

1.1. në qoftë se përcaktohet më vonë se zbritja e TVSH-së së zbritshme është llogaritur më lartë ose më ulët sesa shuma për të cilën personi i tatueshëm ka pasur të drejtë.

1.2. pasi që të dorëzohet deklarata e TVSH-së, ndodhin ndryshime në faktorët që shfrytëzohen për zbritje të TVSH-së së zbritshme, ku për shembull blerjet anulohen ose çmimet janë ulur pasi që ka ndodhë furnizimi.

2. Në lidhje me mallrat kapitale, rregullimi duhet të kryhet gjatë pesë (5) viteve kalendarike. Për pasurinë e paluajtshme duhet të vlejë një periudhë njëzet (20) vjeçare.

3. Periudha korigjuese që i referohet paragrafit 2. të këtij neni duhet të konsiderohet si pesë vjet duke filluar me dhe përfshirë vitin në të cilin ka filluar shfrytëzimi i pajisjes. Në rast të pasurisë së paluajtshme njëzet (20) vjet kalendarik duke filluar me dhe përfshirë vitin kur ka filluar të shfrytëzohet objekti.

4. Rregullimet vjetore duhet të bëhen vetëm në lidhje me një të pestën (1/5), respektivisht një të njëzetën (1/20) të TVSH-së së ngarkuar mbi mallrat kapitale. Ky rregullim duhet të bëhet mbi bazat e ndryshimeve të së drejtës së zbritjes për vitet

pasuese në lidhje me TVSH-në e zbritshme që është zbritur në lidhje me mallrat kapitale. Nuk do të bëhet asnjë rregullim në zbritjen e TVSH-së së zbritshme nëse diferenca në proporcionin aktual të zbritshëm (koeficienti i kreditimit tatimor) është më pak se sa tre përqind (3%) të pikëve.

5. Nëse këto furnizohen gjatë periudhës së rregullimit, mallrat kapitale duhet të trajtohen sikur të jenë aplikuar në një aktivitet ekonomik të personit të tatueshëm derisa të përfundon periudha rregulluese. Aktiviteti ekonomik duhet të supozohet se është plotësisht i tatueshëm në rastet kur furnizimi i mallrave kapitale është i tatuar. Aktiviteti ekonomik duhet të supozohet se është plotësisht i liruar në rastet kur furnizimi i mallrave është i liruar. Rregullimi që parashihet në paragrafin 4. të këtij neni do të bëhet vetëm njëherë lidhur me gjithë periudhën e mbuluar nga periudha korrigjuese që mbetet për tu shfrytëzuar.

6. Ministri i Financave duhet nxjerrë rregullat praktike për të regjistruar rregullimet e TVSH-së dhe për të përcaktuar TVSH-në e zbritshme dhe të pa-zbritshme në lidhje me këto rregullime.

## **Neni 25**

Neni 45 i ligjit bazik , nën-paragrafi 1.12. riformulohet me tekstin si në vijim:

1.12. nëse personi i tatueshëm furnizon mallra ose shërbime ku klienti është i obliguar të paguajë TVSH-në, duhet të bëhet referencë në dispozitën e aplikueshme të këtij ligji ose ndonjë referencë tjetër që tregon se furnizimi i mallrave ose shërbimeve i nënshtrohet procedurës së ngarkesës së kundërt duke u referuar në nën-paragrafët 1.2., 1.3. dhe 1.4. të nenit 52 të ligjit bazik.

## **Neni 26**

1. Neni 52 i ligjit bazik, në fund të nën-paragrafit 1.2. shtohet teksti si në vijim :

“Kjo nuk aplikohet për shërbimet lidhur me lejimin e hyrjes në ngjarjet kulturore, artistike, sportive, shkencore, edukative ose të ngjashme, si panairët dhe ekspozitat dhe lidhur me shërbimet ndihmëse që kanë të bëjnë me lejimin e hyrjes”.

2. Neni 52 i ligjit bazik, paragrafi 5. riformulohet me tekstin si në vijim:

5. Personi i tatueshëm i cili nuk është i themeluar në Kosovë, duhet të emëroj përfaqësuesin tatimor si person të obliguar për të paguar TVSH-në, dhe për ushtrimin e të gjitha të drejtave të tij, në përjashtim për rastet e përkufizuara në nën-paragrafin 1.2. të nenit 26 të këtij ligji dhe nën-paragrafi 1.3. të nenit 52 të ligjit bazik., kur pranuesi është i obliguar të paguajë TVSH-në.

3. Neni 52 i ligjit bazik, pas paragrafit 5. shtohet një paragraf të ri 6. me tekstin si në vijim:

6. Ministri i Financave mundet që, përmes aktit nën-ligjor, në rast të mallrave të shitura në ankande apo nga ndërmjetësuesit të sigurojë që personi, përveç personit që është i obliguar për të paguar TVSH-në, do të jetë i obliguar qoftë bashkërisht apo individualisht për të paguar TVSH-në.

### **Neni 27**

1. Neni 64 i ligjit bazik, paragrafi 3. në fund të nën-paragrafit 3.3. shtohet teksti “dhe nën-paragrafi 1.1. i nenit 28 të këtij ligji për të cilën periudha kalimtare përfundon me 31 dhjetor 2014.

2. Neni 64 i ligjit bazik, nën-paragrafi 3.4. fshihet nga teksti i ligjit.

3. Neni 64 i ligjit bazik, nën-paragrafi 3.5. bëhet nën-paragrafi 3.4.

4. Neni 64 i ligjit bazik, nën-paragrafin 3.4. kreu me numër romak “XX” zëvendësohet me “XIX”.

### **Neni 28**

Pas nenit 62 të ligjit bazik, shtohet neni i ri 62.A, me tekstin si në vijim:

### **Neni 62.A**

Procedurat për kontestimin e vendimit të bërë nga autoritetet tatimore në administrimin e tatimit të vlerës së shtuar, duhet të zbatohet në përputhje me procedurat e parapara me Ligjin nr.03/L-222 për plotësimin dhe ndryshimin e ligjit për administratën tatimore dhe procedurat.

**Neni 29**  
**Hyrja në Fuqi**

Ky ligj hyn në fuqi pesëmbëdhjetë (15) ditë pas shpalljes në Gazetën zyrtare të Republikës së Kosovës.

**Ligji Nr. 04/ L-108**  
**3 maj 2012**

**Kryetari i Kuvendit të Republikës së Kosovës,**

---

**Jakup KRASNIQI**